**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
***Qeveria –Vlada-Government***
***Ministria e Punëve te Brendshme / Ministarstvo Unutrašnjih Poslova / Ministry Of Internal Affairs***

# STRATEGJIA SHTETËRORE KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR DHE PLANI I VEPRIMIT

# 2018 – 2022

2018

## Përmbajtja


**1 Hyrje** ........ **6**

1.1 Qëllimi ........ 5

1.2 Vizioni ........ 5

1.3 Përkufizimi i termave ........ 5

**2 Metodologjia** ........ **7**

**3 Parimet e Përgjithshme** ........ **8**

**4 Analiza e situatës aktuale** ........ Error! Bookmark not defined.

**5 Korniza ligjore dhe mekanizmat institucional** ........ Error! Bookmark not defined.

5.1 Korniza ligjore ........ **Error! Bookmark not defined.**

**6 Objektivat e Strategjisë kundër Krimit te Organizuar** ........ Error! Bookmark not defined.

**7 Zbatimi, monitorimi dhe vlerësimi i Strategjisë** ........ Error! Bookmark not defined.

7.1 Roli i sistemit të monitorimit dhe vlerësimit ........ **Error! Bookmark not defined.**

7.2 Kapacitetet institucionale për monitorim e vlerësim ........ 16

7.3 Indikatorët për monitorim dhe vlerësim ........ 16

7.4 Instrumentet e monitorimit dhe vlerësimit ........ 16

**8 Plani i Veprimit 2019-2022** ........ **17**

# Lista e shkurtesave

| | |
|---|---|
| ZKM | Zyra e Kryeministrit të Kosovës |
| MPB | Ministria e Punëve të Brendshme |
| PK | Policia e Kosovës |
| AKI | Agjencia e Kosovës për Inteligjencë |
| DK | Dogana e Kosovës |
| PSRK | Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës |
| MD | Ministria e Drejtësisë |
| MFSK | Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës |
| MIE | Ministria e Integrimit Evropian |
| AME | Agjencia e Menaxhimit Emergjent |
| NJIF | Njësia për Inteligjencës Financiare |
| AKMRRSB | Agjencia e Kosovës për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguria Bërthamore |
| MF | Ministria e Financave |
| KGJK | Këshilli Gjyqësor i Kosovës |
| KPK | Këshilli Prokurorial i Kosovës |
| MKRS | Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve |
| MPMS | Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale |
| MPJ | Ministria e Punëve të Jashtme |
| MTI | Ministria e Tregtisë dhe Industrisë |
| MAPL | Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal |
| ICITAP | Programi për ndihmë ndërkombëtare në trajnim për hetim të krimit |
| OSBE | Organizata për Bashkëpunim dhe Siguri në Evropë |
| EULEX | Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë |
| ATK | Administrata Tatimore e Kosovës |
| AKK | Agjencia Kundër Korrupsionit |
| MASHT | Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë |
| ICITAP | Programi Ndërkombëtar i Asistencës në Trajnim për Hetimet Penale |
| BQK | Banka Qendrore e Kosovës |
| AAPSK | Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar |
| AD | Akademia e Drejtësisë |
| AKSP | Akademia e Kosovës për Siguri Publike |

# Përmbledhje ekzekutive

Kjo strategji është një dokument i cili do ta prezantojë situatën e përgjithshme, situatën aktuale, mekanizmin institucional, dobësitë e tanishme, parimet themelore në luftimin e krimit të organizuar së bashku me disa faktorë kryesorë për arritje të suksesit dhe më në fund do t'i përcaktojë synimet dhe mënyrat e mundshme për arritjen e tyre. Strategjia Kombëtare kundër Krimit të Organizuar e Republikës së Kosovës, për periudhën 2018-2022, është vazhdimësi e strategjisë paraprake dhe mbështetet në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, legjislacionin e aplikueshëm në Republikën e Kosovës, dokumentet përkatëse të planifikimit të politikave në Kosovë si dhe instrumentet ligjore ndërkombëtare dhe praktikat më të mira ndërkombëtare në fushën e parandalimit dhe luftimit të krimit të organizuar. Përderisa strategjia paraprake ka pasur si qëllim kryesor themelimin-ndërtimin e mekanizmit institucional, kjo strategji ka për qëllim të ngritë efikasitetin dhe efektivitetin e institucioneve dhe shoqërisë kosovare në këtë fushë. Kjo strategji është e strukturuar në mënyrë të tillë që të identifikojë qartë objektivat dhe aktivitetet që duhet të përmbushën, në mënyrë që i gjithë mekanizimi institucional të vihet në funksion të parandalimit dhe luftimit me sukses të Krimit të Organizuar në Kosovë, si dhe duke qenë partner serioz me vendet tjera në përpjekjet ndërkombëtare në luftë kundër kësaj dukurie përmes bashkëpunimit ndërkombëtarë. Diversiteti apo shumëllojshmëria e operacioneve të grupeve të ndryshme kriminale dhe lokacioni apo territori ku ato veprojnë u ofron mjete që në mënyrë më efektive t'i adaptohen situatave të ndryshueshme në një vend, gjersa i shfrytëzojnë dobësitë e bashkëpunimit ndërkombëtarë të organeve për zbatim të ligjit. Në këtë kontekst, nuk ka asnjë shtet i cili është tërësisht i sigurt dhe i mbrojtur nga krimi i organizuar, prandaj përjashtim nga kjo nuk bën as Republika e Kosovës. Kjo strategji ka për qëllim që të rrisë akoma më shumë përpjekjet e institucioneve të Kosovës në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtarë. Strategjia Kombëtare kundër Krimit të Organizuar ka për qëllim të ndihmojë zhvillimin dhe zbatimin e politikave duke forcuar kapacitetet institucionale kundër krimit të organizuar në të gjitha nivelet e organizimit institucional dhe shoqëror. Politikat për kontrollimin dhe parandalimin e krimit të organizuar duhet të bazohen në të kuptuarit më të thellë se çka paraqet sipas standardeve ndërkombëtare, krimi i organizuar, cila është fushëveprimtaria, metodat e operimeve dhe trendët e krimit në një shtet apo regjion të caktuar. Qëllimi i strategjisë është që me përdorim sa më racional të burimeve materiale, financiare dhe njerëzore të arrihet ngritja e mekanizmit institucional, bashkëpunimit dhe koordinimit në luftë kundër krimit të organizuar. Republika e Kosovës bën përpjekje të përmirësojë situatën në fushën e sundimit të ligjit dhe të merret në mënyrë efikase me luftimin e krimit të organizuar, i cili është si kusht për progres drejt rrugës evropiane, duke zbatuar një politikë të besueshme dhe reale në këtë aspekt.

Qëllimi i kësaj strategjie është zhvillimi i mëtejmë i politikave për marrjen e përgjegjësive për mbrojtjen e individit dhe shoqërisë, dhe problemet që janë pasojë e krimit të organizuar.

Hartimi i kësaj strategjie kombëtare orientohet në përcaktimin e objektivave dhe përgatitjen e kuadrit si dhe veprimeve të përbashkëta të të gjitha institucioneve që do të ndërmarrin në pesë vitet e ardhshme 2018-2022.

# 1 Hyrje

Krimi i organizuar konsiderohet si kërcënim ndaj sigurisë së brendshme si dhe asaj ndërkombëtare. Ky kërcënim mund të manifestohet në forma të ndryshme në përputhshmëri me zhvillimin e jetës ekonomike dhe shoqërore, sidomos në kushtet e globalizmit.
Aktivitetet e krimit të organizuar në periudhën e globalizimit janë perfeksionuar shumë, sepse shumë grupe të krimit të organizuar operojnë me mjete teknike shumë të sofistikuara, e që është vështirë t'iu bihet në gjurmë. Krimi i organizuar në formën më të thjeshtë ka formën e një grupi kriminal i cili kyçet në aktivitete kriminale në forma të ndryshme. Përmes aktiviteteve trans-nacionale grupet e krimit të organizuar janë bërë protagonistë kryesorë në industritë ilegale, siç janë: prodhimi i drogës dhe trafikimi me qenie njerëzore të cilat kanë shtrirje globale dhe nganjëherë kanë profitin më të madh se BPV-ja e disa shteteve.
Rrjetet ndërkombëtare kriminale, po ashtu kanë fleksibilitet që shpejt dhe me kreativitet t'iu adaptohen përpjekjeve të organeve për zbatimin e ligjit. Këto grupe janë në gjendje që me sukses t'i shmangen përpjekjeve të organeve për zbatim të ligjit e sidomos organeve përgjegjëse për parandalim dhe luftim të krimit përmes operacioneve të cilat janë të përfshira në arenën ndërkombëtare duke i kaluar shumë herë kufijtë kombëtarë të shteteve.
Shkalla e lartë e papunësisë dhe varfëria, gjithashtu kontribuojnë në krijimin e kushteve të përshtatshme për zhvillimin e krimit në përgjithësi dhe krimit të organizuar në veçanti.
Në nivelin global nuk ka pasur një kuptim të përgjithësuar sa i përket krimit të organizuar deri në vitin 2004, kur për herë të parë është aprovuar Konventa e Kombeve të Bashkuara për Luftimin e Krimit të Organizuar.
Kjo konventë paraqet konturat e përkufizimit të krimit të organizuar si dhe definon elementet përbërëse të kësaj vepre penale. Sipas kësaj konvente, krimi i organizuar përkufizohet si: "një grup i strukturuar prej tre ose më shumë personash, që veprojnë në bashkëpunim, me qëllim që të sigurojnë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, një përfitim financiar ose një përfitim tjetër material".
Konventa në fjalë përmban edhe protokollet shtesë të cilat në mënyrë specifike adresojnë çështje që kanë të bëjnë me:

1. Parandalimin, hetimin dhe dënimin e trafikimit të personave;
2. Kontrabandimin me migrantë;
3. Prodhimi kundërligjshëm dhe trafikimi me armë, pjesëve të tyre dhe municion.

Edhe Bashkimi Evropian, bazuar në konventën e lartpërmendur ka bërë përkufizimin për krimin e organizuar. Sidoqoftë, përpjekjet për kuptim të përbashkët të krimit të organizuar në BE kanë zanafillë të mëhershme dhe atë qysh në vitin 1997, ku BE-ja ka ratifikuar një dokument që bazohet në një listë prej 11 karakteristikave të krimit të organizuar.
Republika e Kosovës, në kodin penal të saj, mbështetur edhe në Konventën e Kombeve të Bashkuara për Luftimin e Krimit të Organizuar dhe Protokollet e saj, ka përkufizuar krimin e organizuar, si krim i rëndë i kryer nga ndonjë grup i strukturuar për të përfituar drejtpërsëdrejti ose tërthorazi dobi pasurore a financiare.
Kodi në fjalë, po ashtu jep edhe përkufizimet për grupin kriminal të organizuar dhe të strukturuar si dhe krimin e rëndë, ekzistenca e të cilit është edhe parakusht për cilësimin e kësaj vepre.

Në bazë të kësaj, me grup kriminal të organizuar nënkuptojmë grup i strukturuar i cili ekziston për një kohë të caktuar dhe i cili vepron në bashkëpunim, me qëllim të kryerjes së një ose më shumë krimeve të rënda për përfitim të drejtpërdrejtë ose tërthortë të dobisë pasurore apo financiare.
Grup i strukturuar nënkupton grupin prej tre ose më shumë personave i cili nuk është formuar rastësisht për kryerjen e ndonjë vepre penale të çastit dhe nuk do të thotë formalisht t'i ketë të përkufizuara rolet për anëtarët e tij, vazhdimësinë e anëtarësisë së tij apo strukturën e zhvilluar.
Po ashtu, KPRK përkufizon edhe krimin e rëndë dhe atë si vepër penale që dënohet me burgim prej së paku katër vjet.

## 1.1 Qëllimi

Qëllimi i kësaj strategjie është që me përdorim sa më racional të burimeve materiale, financiare dhe njerëzore të zhvillojë politika për marrjen e përgjegjësive në parandalimin ,luftimin e krimit të organizuar si dhe mbrojtjen e individit dhe shoqërisë nga krimi i organizuar.

## 1.2 Vizioni

Vizioni i kësaj strategjie është ndërtimi i një shoqërie të sigurt duke minimizuar dhe pamundësuar aktivitetet e krimit të organizuar në territorin e Republikës së Kosovës.

# 2 Metodologjia

Strategjia Shtetërore kundër Krimit të Organizuar dhe Plani i Veprimit 2018-2022 është hartuar në mbështetje të Planit Vjetor të Punës së Qeverisë dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme për vitin 2018 dhe Programit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit 2017-2021.

Strategjia është në harmoni të plotë me Udhëzimi Administrativ nr. 07/2018 për procedurat, kriteret dhe metodologjinë e përgatitjes dhe miratimit të dokumenteve strategjike dhe planeve për zbatimin e tyre si dhe me Rregulloren (QRK) nr. 05/2016 për standardet minimale për procesin e konsultimit publik.
Grupi i Punës për hartimin e Strategjisë, është formuar nga Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme, me Vendimin Nr. 223/2017, të datës 26.07.2017, ku janë të përfshira të gjitha institucionet përkatëse shtetërore, shoqëria civile dhe partnerët ndërkombëtarë. Drafti i strategjisë është hartuar me përfshirjen e të gjithë akterëve të grupit punues, ndërsa më qëllim të finalizimit të draftit është mbajtur punëtoria prej 23.10.2017 deri me 26.10.2017, e mbështetur nga Zyra e BE-së në Kosovë

Strategjia është hartuar duke u bazuar në vlerësimet e brendshme si analizat vjetore të zbatimit të strategjisë së mëparshme për vitet 2012-2017, vlerësimit të kërcënimit nga Krimet e Rënda dhe Krimi i Organizuar (SOCTA), raportet analitike dhe vlerësuese të Policisë së Kosovës dhe Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë, si dhe dokumentet tjera përkatëse. Në anën tjetër, vlerësimet e jashtme

përfshijnë raportet e Departamentit të Shtetit Amerikan, raporteve të EUROPOL-it për situatën e Krimit të Organizuar dhe trendit në BE, raportet e Komisionit Evropian si dhe dokumentet tjera.

# 3 Parimet e Përgjithshme

Struktura dhe përmbajtja e këtij dokumenti bazohet në këto parime:

1. **Parimi i kushtetutshmërisë dhe i ligjshmërisë** - veprimet e ndërmarra për të parandaluar dhe luftuar Krimin e Organizuar bazohen në dispozitat e parapara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, legjislacionit në fuqi dhe marrëveshjet ndërkombëtare.

2. **Parimi i qasjes gjithëpërfshirëse shtetërore –** parandalimi dhe luftimi efektiv i kërcënimeve te krimit te organizuar arrihet përmes përfshirjes dhe bashkëpunimit të ngushtë në mes të institucioneve qeveritare, publike, shoqërisë civile, sektorit privat dhe organizatave ndërkombëtare.

3. **Parimi i lirive dhe të drejtave të njeriut –** nënkupton garantimin e lirive dhe të drejtave të gjithë individëve, gjatë të gjitha fazave të angazhimit të institucioneve në parandalimin dhe luftimin e Krimit te Organizuar.

4. **Parimi i konfidencialitetit** – institucionet me përgjegjësi në parandalimin dhe luftimin e Krimit te Organizuar duhet të sigurojnë ruajtjen e konfidencialitetit të informatave të shkruara dhe jo të shkruara të shkëmbyera gjatë procesit të hetimeve dhe diskutimeve.

5. **Parimi i bashkëpunimit** – Qeveria e Republikës së Kosovës është e përkushtuar në respektimin e bashkëpunimit dhe bashkërendimit të aktiviteteve midis institucioneve vendore dhe bashkëpunimin ndërkombëtarë në luftën kundër Krimit të Organizuar.

6. **Parimi i besueshmërisë** – Institucionet përgjegjëse për parandalimin dhe luftimin e Krimit të Organizuar duhet të kujdesën për ndërtimin e besimit në ruajtjen e integritetit të hetimeve, të dhënave dhe informacioneve nga keqpërdorimi nga ata që kanë qasje në to.

7. **Parimi i proporcionalitetit** – nënkupton ushtrimin e autoritetit të institucioneve që merren në parandalimin dhe luftimin e Krimit të Organizuar, vetëm atëherë kur është e domosdoshme dhe vetëm deri në nivelin që nevojitet për të arritur objektivat legjitime, me mjete dhe metoda të përshtatshme, kohë sa më të shkurtër të mundshme.

8. **Parimi i bashkëpunimit ndërkombëtar** – parandalimi dhe luftimi efikas i Krimit të Organizuar arrihet përmes bashkëpunimit ndërkombëtar me shtete, organizata dhe iniciativa. Përmes bashkëpunimit, Republika e Kosovës do të luajë rol qenësor në luftën globale kundër Krimit të Organizuar.

# 4. SITUATA AKTUALE

Republika e Kosovës ka përcaktuar qartë vizionin dhe interesat e saja dhe njëkohësisht do të luftojë të gjitha format e krimit të organizuar, do të përcjellë dhe zbatojë me përkushtim të gjitha proceset demokratike, ekonomike, sociale, politike dhe reformat institucionale, në procesin e integrimit në Bashkimin Evropian dhe në integrimet euroatlantike.
Krimi i Organizuar në Republikën e Kosovës paraqitet me specifikat e veçanta, prandaj edhe luftimi i tij nga institucionet përgjegjëse është kompleks dhe shumë dimensional, ku grupet e organizuara kriminale vlerësohet të jenë mjaft komplekse dhe mirë të organizuara, të cilat shtrihen në grupe më të vogla të cilat janë mjaft efektive në arritjen e qëllimeve të tyre, ndërsa në anën tjetër, shkalla e përhapjes dhe zhvillimit të këtij lloji kriminaliteti është përcaktuar nga niveli i reagimit institucional dhe shoqëror ndaj tij.
Raporte të ndryshme të agjencive ligjzbatuese dhe organizatave të pavarura brenda dhe jashtë vendit, e potencojnë prej kohësh ekzistencën e krimit të organizuar në Kosovë, prandaj në ditët e sotme, krimi i organizuar përbën një kërcënim serioz për sigurinë kombëtare dhe ndërkombëtare dhe paraqet pasoja të dëmshme për shëndetin dhe sigurinë publike, institucionet demokratike, stabilitetin makro-financiar dhe ekonomik.
Nën ndikimin e fuqishëm të faktorëve të ndryshëm janë zhvilluar dhe përsosur forma të krimit të organizuar rajonal e ndërkombëtar të trafikimit të drogës, trafikimit me njerëz, kontrabandës me armë, krimit kibernetikë, si dhe pastrimit të parave.
Bazuar në vlerësimet analitike nga institucionet e sigurisë, por edhe të dhënat tjera nga dokumente akademike (libra universitar mbi Krimin e Organizuar) vlerësohet se grupet e organizuara kriminale në Kosovë duke mos njohur barriera në aspektin e nacionalitetit të tyre, kanë arritur t'i perfeksionojnë rrugët e tyre të komunikimit dhe bashkëpunimit gjatë aktiviteteve kriminale në nivelin regjional dhe më gjerë.
Grupet e organizuara kriminale në Kosovë karakterizohen me disa karakteristika si në vijim: struktura hierarkike, besnikëria, bashkëpunimi në mes grupeve kriminale, diversiteti i krimit, ashpërsia dhe agresiviteti, korruptimi i zyrtarëve dhe disa karakteristika tjera.
Grupet kriminale në Kosovë kryesisht përbëhen nga anëtarë të nacionalitetit të njëjtë, por ka raste kur brenda grupeve ka pjesëtarë të nacionaliteteve të ndryshme ku dominojnë ata të nacionalitetit shqiptar dhe serb, të cilët aktivitetin e tyre kriminal e shtrijnë brenda dhe jashtë Kosovës, dhe bashkëpunojnë me grupet kriminale të rajonit dhe më gjerë, janë aktive në qëllimet kriminale, e shfrytëzojnë mirë situatën e brishtë ekonomike, politike dhe të sigurisë.
Përfitimet materiale të realizuara nga krimi i organizuar janë shumë të larta, prej kësaj, anëtarët e grupeve kriminale zhvillojnë veprimtari të biznesit legal, të cilëve ju ka mundësuar t'i fshehin përfitimet e tyre të mëdha nga kriminaliteti dhe t'i adresojnë në kuadër të këtyre bizneseve, gjithashtu përfshirja në këto biznese u siguron atyre një imazh më të mirë në shoqëri dhe shmangie nga organet ndjekëse të shtetit.
Qasja dhe lufta institucionale në parandalimin dhe luftimin e formave të ndryshme të krimit të organizuar në Republikën e Kosovës, ka vazhduar të përcillet nga disa vështirësi në aspektin e koordinimit ndërinstitucional, rajonal dhe ndërkombëtar. Vështirësi dhe sfidë të veçantë në vazhdimësi po paraqet mos anëtarësimi i agjencive të sigurisë së Republikës së Kosovës në disa organizata ndërkombëtare, siç janë: EUROPOL-i, INTERPOL-i etj.
Efektet shkatërruese, direkte dhe ato indirekte, të cilat janë rezultat i aktiviteteve kriminale të grupeve të organizuara kriminale brenda dhe jashtë territorit tonë, paraqesin një rrezik shumë të madh për sigurinë e Republikës së Kosovës dhe të qytetarëve të saj.
Këto efekte është duke i ndier ekonomia jonë e gjendur edhe ashtu ende në fazat e zhvillimit dhe stabilitetit të saj makro-financiarë.

Duke mos njohur barriera në aspektin e nacionalitetit të tyre, grupet kriminale kanë arritur t'i perfeksionojnë rrugët e tyre të komunikimit gjatë ushtrimit të aktiviteteve kriminale në nivelin regjional dhe transnacional.
Në pjesën veriore të Kosovës, sa i përket krimit të organizuar, situata tani paraqitet më stabile për faktin se janë shtuar kontrollet policore dhe doganore, është bërë funksionalizimi i dy pikave kalimeve kufitare, ka filluar shtrirja dhe funksionalizimi i institucioneve Kosovare në nivelin lokal dhe qendror, por edhe përkundër kësaj, grupet e krimit të organizuar vazhdojnë të shfrytëzojnë rrugë alternative, përmes të cilave janë duke i zhvilluar të gjitha format e krimit të organizuar.
Situata aktuale në raport me aktivitetet e grupeve kriminale në Republikën e Kosovës përfshinë këto forma të krimit të organizuar: trafikimin me narkotikë, trafikimin me njerëz, kontrabanda me mallra, kontrabandimi me migrantë, trafikimi me armë, krimet kompjuterike, korrupsioni dhe shpëlarja e parave.
Trafikimi i lëndëve narkotike është mjaft shqetësuese, edhe pse si rezultat i zhvillimeve në nivel global dhe reduktimit të ofertës vërehet një ulje e konsiderueshme e sasisë së lëndës narkotike, e cila hyn në Kosovë apo kalon përmes Kosovës me qëllim të trafikimit të saj në vendet e BE-së. Megjithatë, shqetësues mbetet numri i përdoruesve të lëndës narkotike, marihuana, duke përfshirë edhe drogat e forta, siç janë: Heroina dhe Kokaina. Kontrabanda me mallra vazhdon të paraqet kërcënim kryesor për Kosovën dhe qytetarët e saj. Kontrabanda me mallra kryesisht është e bazuar në mallrat që iu nënshtrohen taksave doganore, TVSH-së e në veçanti, mallrat qe i nënshtrohen taksës së akcizës. Megjithatë, mjaft evidente është edhe kontrabandimi i produkteve ushqimore, veçanërisht produkteve të mishit dhe produkteve medicionale, të cilat rrezikojnë seriozisht shëndetin dhe jetën e qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Trafikimi me njerëz, aktualisht mbetet mjaft shqetësues, kryesisht është i fokusuar në trafikimin e brendshëm të viktimave, por më pak edhe i viktimave të trafikimit nga vendet e rajonit. Element shqetësues është trendi në rritje i viktimave të trafikimit të moshave të reja, duke përfshirë edhe moshën e mitur.

Trafikimi i armëve vazhdon të mbetet shqetësim dhe sfidë për institucionet e sigurisë në Kosovë. Kosova është vend destinacioni, por edhe vend transiti, kryesisht për trafikim në mes të strukturave kriminale që veprojnë në vendet e rajonit. Një numër i konsiderueshëm i armëve edhe më tutje vazhdon të mbetet në duar të popullsisë. Armët e kontrabanduara hyjnë e dalin nga Kosova përmes të gjitha vendeve fqinje dhe në të gjitha këto vende kontrabandistët kosovarë blejnë edhe shesin armë. Krimet kompjuterike si rezultat i zhvillimit të teknologjisë së informacionit janë fenomen në rritje që ofrojnë mundësi për ndërhyrje në të dhënat senzitive që çojnë nga cenimi i integritetit dhe mirëqenies se një individi të veçantë deri në cenimin e sigurisë kombëtare. Këto krime shfaqen me qëllim të përfitimit, me anë të vjedhjes dhe mashtrimit përmes kartelave bankare, pornografisë së fëmijëve në internet dhe hyrjet e paautorizuara në sistemet kompjuterike nëpërmjet thyerjes së masave të sigurisë së sistemeve apo programeve kompjuterike, futjes së paligjshme në faqet zyrtare të internetit të subjekteve publike dhe private me qëllim mosfunksionimin e tyre dhe prishjen e imazhit por edhe për qëllime të propagandës nga individë apo grupe të caktuara.

Korrupsioni paraqitet me ndikim me pasoja politike dhe ekonomike, krijon një kulturë të mos ndëshkueshmerisë, bllokon rritjen ekonomike, bëhet pengesë për investimet private vendore dhe të huaja, tregtinë dhe zhvillimin ekonomik të vendit.
Korrupsioni dhe shpëlarja e parave përbëjnë një nga format më të avancuar të krimit të organizuar në jetën institucionale dhe përbëjnë njërin ndër rreziqet më të mëdha për sigurinë nacionale dhe atë të qytetarit. Korrupsioni vazhdon të jetë më i përhapur në fushën e prokurimit publik, shëndetësisë, privatizimit, ndërsa shpëlarja e parasë e cila rrjedh nga aktivitet kriminale kryesisht është e orientuar në investime; në prona të paluajtshme dhe të luajtshme. Shumat e mëdha të parave të fituara në

mënyrë të kundërligjshme, përmes zhvatjeve apo forma të tjera të korrupsionit, kryesisht janë futur në tregun e patundshmërive, lojërave të fati, ndërtimeve të larta kolektive dhe monedhave virtuale.

Sektori i lojërave të fatit, mundëson shpëlarjen e parave si dhe përfitime të kundërligjshme përmes shmangies tatimore dhe doganore, si dhe aktiviteteve tjera të kundërligjshme.

Efektet negative të korrupsionit dhe pastrimit të parave shfaqen në disa drejtime: dëmton sektorin financiar, ul besueshmërinë e investitorëve të huaj, dëmton konkurrencën e lirë, i jep mundësi aktivitetit kriminal të sigurojë vazhdimësinë.
Ndër faktorët lehtësues të korrupsionit mund të rendisim:

- Toleranca sociale e komunitetit ndaj korrupsionit për shkak të përfitimeve, lehtësirave dhe mundësive që ofrojnë veprimet korruptuese;
- Niveli i ulët i ndëshkueshmerisë nga gjyqësori ndaj veprimeve korruptuese, që është edhe shkak edhe pasojë për rritjen e nivelit të korrupsionit;
- Vështirësitë për të goditur korrupsionin në nivelet më të larta të administratës dhe në sistemin e drejtësisë.

Mangësitë ( zbrazëtirat ligjore) e paraqitura në Ligjin për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë, e vështirësojnë sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurisë që dyshohet se është fituar nga aktiviteti kriminal.

Duke u bazuar në analizat e rregullta të strukturave të sigurisë në Republikën e Kosovës dhe analizat e rregullta të institucioneve të sigurisë në Bashkimit Evropian, dhe më gjerë, indikacionet e para flasin për diversitetin dhe perfeksionimin e grupeve kriminale në Bashkimin Evropian në përgjithësi dhe në Republikën e Kosovës dhe në regjionin tonë në veçanti. Grupet kriminale janë në gjendje që të përshtaten dhe të veprojnë në varësi nga kushtet për ushtrimin e aktivitetit kriminal. Këto grupe janë bërë shumë më shumë bashkëpunuese dhe polikriminale.

Institucionet e sigurisë, duhet ta kenë parasysh që këto dukuri nuk mund të luftohen në mënyrë dhe rrugë individuale vetëm nga agjencitë e zbatimit të ligjit. Parandalimi dhe luftimi i krimit kërkon bashkëpunim dhe koordinim ndërinstitucional me një nivel qendror të koordinimit dhe analizës së inteligjencës me qëllim të ndikimit në parandalim dhe luftim.
Identifikimi, lokalizimi dhe profilizimi i grupeve kriminale në aspektin lokal, do të ndihmonte institucionet e sigurisë në lokalizimin dhe profilizimi të grupeve kriminale në nivel regjional dhe ndërkombëtar.
Vështirësitë shfaqen në rastet e dekonspirimit të veprimeve operative në drejtim të parandalimit dhe luftimit të grupeve të organizuara kriminale.
Trajtimi dhe koordinimi më gjithëpërfshirës në aspektin lokal, regjional dhe ndërkombëtar do të jetë çelësi i suksesit në luftë kundër krimit të organizuar.
Trajtimi strategjik, qasja profesionale dhe përdorimi i praktikave më të mira, do të ndihmonte në identifikimin, profilizimin dhe penalizmin e strukturave kriminale.
Institucionet përgjegjëse duhet t'i ngritin kapacitetet e tyre në fuqizimin e politikave të shëndosha kadrovike, sidomos në kuadër të agjencive të sigurisë, sistemit prokurorial dhe gjyqësor si dhe institucioneve të tjera për zbatimin e ligjit.

# 5. KORNIZA LIGJORE

Në luftë kundër krimit të organizuar, Republika e Kosovës ka në fuqi një bazë të gjerë të legjislacionit ku, si legjislacion parësor mund të përmenden, por nuk kufizohet vetëm tek:

1. Kushtetuta e Republikës së Kosovës[1];
2. Kodi nr. 04/L-082 Penal i Republikës së Kosovës[2];
3. Kodi nr. 04/L-123 i Procedurës Penale[3];
4. Ligji nr. 04/L-076 për Policinë[4];
5. Ligji nr. 02/L-128 për Barnat Narkotike, Substancat Psikotrope dhe Prekursorë[5];
6. Ligji nr. 03/L063 për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë[6];
7. Ligji nr. 03/L-199 për Gjykatat[7];
8. Ligji nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit[8];
9. Ligji nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës[9];
10. Ligji nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës[10];
11. Ligji nr. 03/L-052 për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës[11];
12. Ligji nr. 03/L-053 mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë[12];
13. Ligji nr. 04/-L-015 për Mbrojtjen e Dëshmitarëve[13];
14. Ligji nr. 04/L-043 për Mbrojtjen e Informatorëve[14];
15. Kodi nr. 03/L-193 i Drejtësisë për të Mitur[15];
16. Kodi nr. 03/L-109 Doganor dhe i Akcizave[16];
17. Ligji nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale[17];
18. Ligji nr. 03/L-183 për Zbatimin e Sanksionove Ndërkombëtare[18];
19. Ligji nr. 05/L-060 për Mjekësinë Ligjore[19];
20. Ligji nr. 03/L-142 për Rendin dhe Qetësinë Publike[20];
21. Ligji nr. 05/L -096 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit[21];

---

1 http://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702
2 https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2834
3 https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2861
4 https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2806
5 https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2572
6 https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2538
7 https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2700
8 https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2710
9 https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2709
10 https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2713
11 https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2526
12 https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2527
13 https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2758
14 https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2763
15 https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2698
16 https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2600
17 https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8867
18 https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2674
19 https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12325
20 https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2651
21 https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12540

22. Ligji nr. 03/L-231 për Inspektoratin Policor të Kosovës[22];
23. Ligji nr. 03/L-216 mbi Themelimin e Sistemit për Sigurimin e Depozitave për Institucionet Financiare në Kosovë[23];
24. Ligji nr. 04/L-030 për Përgjegjësinë e Personave Juridik për Vepra Penale[24];
25. Ligji nr. 04/L-213 për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Penale[25];
26. Ligji nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare[26];
27. Ligji nr. 04/L-078 për Sigurinë e Përgjithshme të Produkteve[27];
28. Ligji nr. 04/L-072 për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror[28];
29. Ligji nr. 04/L-093 për Bankat Institucionet Mikro-financiare dhe Institucionet Financiare Jo-bankare[29];
30. Ligji nr. 02/L-57 për Institucionet e Kulturës[30];
31. Ligji nr. 03/L166 për Parandalimin dhe Luftimin Kibernetik[31];
32. Ligji nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit[32];
33. Ligji nr. 04/L051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik[33];
34. Ligji nr. 04/L-228 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-050 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë së Zyrtarëve të Lartë Publik, dhe Deklarimin, Prejardhjen, Kontrollin e Dhuratave për të gjithë Personat Zyrtarë[34];
35. Ligji nr. 03/L-238 për Aspektet Civile të Rrëmbimit Ndërkombëtar të Fëmijës[35];
36. Ligji nr. 05/L-049 për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar[36];
37.Ligji nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare[37];
38. Ligji nr. 04/L-216 për Bashkëpunim Ndërmjet Autoriteteve të Përfshira në Menaxhimin e Integruar të Kufirit[38];
39. Ligji nr.05/L-002 për Ndalimin e Bashkimit në Konflikte të Armatosura Jashtë Territorit të Vendit[39];
40. Ligji nr. 04/L-218 për Parandalimin dhe Luftimin e Trafikimit me Njerëz dhe Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit[40];
41. Ligji nr. 05/L -036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit[41];
42. Ligji nr. 05/L -022 për Armë[42];
43. Ligji nr. 04/L-140 për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë së Përfituar me Vepër Penale[43];

22 https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2720
23 https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2867
24 https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2766
25 https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8871
26 https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2789
27 https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2799
28 https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2801
29 https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2816
30 https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2443
31 https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2682
32 https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2662
33 https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2768
34 https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=9445
35 https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2732
36 https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12360
37 https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2447
38 https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8868
39 https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10763
40 https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8875
41 https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10936
42 https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=11018
43 https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8651

44 .Ligji nr. 04/L-050 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë Personat Zyrtarë[44];
45. Ligji Nr. 04/L-198 për Tregtinë e Mallrave Strategjike[45];
46. Ligji nr. 05/L-032 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.03/L-199 për Gjykatat[46];
47. Ligji nr. 05/L -094 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, i Ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin nr. 05/L -033 si dhe Ligjin nr. 04/L-115[47];
48. Ligji nr. 05/L-034 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.03/L-225 për Prokurorin e Shtetit[48];
49. Ligji nr. 04/L -273 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjeve që Ndërlidhen me Mandatin e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Republikën e Kosovës[49];
50. Ligji nr. 05/L-035 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës[50];
51 .Ligji nr. 05/L -129 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale[51];
52. Ligji nr. 04/L-099 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Kodit nr. 03/L-109 Doganor dhe të Akcizave në Kosovë[52];
53. Ligji nr. 04\ L-080 për Lojërat e Fatit[53].

Po ashtu, vlen të theksohet se Republika e Kosovës, me qëllim të kompletimit të infrastrukturës ligjore që ndikon në fushën kundër krimit të organizuar, është në proces të hartimit dhe miratimit të projektligjeve, ku me theks të veçantë vlen të përmenden:

1.Projektligji për Infrastrukturën Kritike;
2. Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L- 178 për Klasifikimin e Informacioneve dhe Verifikimin e Sigurisë;
3. Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L- 172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
4. Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L- 199 për Gjykatat;
5. Projektkodi i Drejtësisë për të Mitur;
6. Projektligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik;
7. Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 02/L- 128 për Barnat Narkotike, Substanca Psikotrope dhe Prekursorë;
8. Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L- 224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës;
9. Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit;
10. Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04\ L-080 për Lojërat e Fatit;
11. Projektkodi Civil i Kovës;
12. Projektkodi për Ndryshimin dhe Plotësimin e Kodit nr. 04/L-123 i Procedures Penale;
13. Projektkodi për Ndryshimin dhe Plotësimin e Kodit nr. nr. 04/L-082 Penal i Republikës së Kosovës;

---

[44] https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2767
[45] https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8860
[46] https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10932
[47] https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12326
[48] https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10934
[49] https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=9477
[50] https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10935
[51] https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=14672
[52] https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2823
[53] https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2813

